



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 571 Akti

Nr. 589 Vendimi
Tiranë, më 22.11.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Alma Faskaj	Relatore
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 21.11.2022, ora 14:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Mirela Kapo**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Mirela Kapo, aktualisht me detyrë ndihmës magjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë¹, është subjekt rivlerësimi, që i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pasi në kohën e dorëzimit të deklaratës *Vetting* ushtronte detyrën e prokurores pranë Prokurorisë në Gjykatën së Rrethit Gjyqësor Krujë.

2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

3. Subjekti i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar me shortin e hedhur në datën 15.6.2020, në përputhje me “Rregullore për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

4. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka kryer një kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit Mirela Kapo, duke krahasuar deklaratën e pasurisë të rivlerësimit kalimtar *Vetting* me deklaratat e pasurisë në vite dhe dokumentacionin justifikues bankar dhe jobankar etj., të dorëzuar nga subjekti me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës pranë institucioneve publike. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja konstaton se për subjektin e rivlerësimit Mirela Kapo:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

5. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka

¹Me vendimin nr.***, datë 4.3.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, znj. Mirela Kapo është komanduar në pozicionin e ndihmës magjistratit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për një periudhë 5-vjeçare.

dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 5.2.2021, të KDZH-së, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Mirela Kapo.

6. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

7. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 22.6.2020, të trupit gjykues, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, për të tria kriteret, bazuar në pikën 1 të nenit 4 të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesues i trupit gjykues komisionere Pamela Qirko. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

8. Në datën 24.11.2020 subjekti i rivlerësimit u njoftua me përbërjen e trupit gjykues, për të cilin në datw 25.11.2020, deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

9. Në datën 11.11.2022 trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Mirela Kapo, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes.

10. Në datën 11.11.2022 trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të paraqesë pretendime/sqarime shtesë brenda datës 17.11.2022. Subjekti i rivlerësimit, me *email*-in e datës 12.11.2022, shprehu dakordësinë lidhur me rezultatet e hetimit, ku deklaroi se nuk ka kundërshtime mbi gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni dhe në datën 14.11.2022 tërhoqi dokumentacionin me dosjen e hetimit.

11. Në datën 17.11.2022 trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Mirela Kapo në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u njoftua me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 21.11.2022, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

12. Në datën 21.11.2022 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte e pranishme.

II. SEANCA DËGJIMORE

13. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Mirela Kapo u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

14. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit Mirela Kapo shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

15. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

16. Znj. Mirela Kapo ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur dhe dërguar dokumentacionin dhe shpjegimet përkatëse sipas kërkesës së Komisionit, sipas 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

17. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

18. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë, të ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

19. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21. Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse. Por, referuar vendimit nr. 2/20171, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga

ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja që gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u vijua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së subjektit, si dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

24. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës *Vetting*, të paraqitur më parë në këtë institucion, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Mirela Kapo.

25. Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

26. Procesi i rivlerësimit për komponentin e pasurisë nga Komisioni, është bazuar në: (i) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (ii) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratat vjetore të pasurisë për vitet 2010 – 2016 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (iii) hetimin e pasurive të personave të tjerë të lidhur; si dhe (iv) dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ.

27. Subjekti i rivlerësimit Mirela Kapo e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë *Vetting* (duke përfshirë personat e lidhur), në datën 26.1.2017, në bazë të ligjit nr. 84/2016, fakt ky i konfirmuar edhe nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Pra, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

28. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se prej vitit 2015 e në vijim, pa ndërprerje, është e martuar me shtetasin E.K² dhe ka dy fëmijë të mitur. Komisioni, mbështetur në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe në certifikatën e përbërjes familjare bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, konstaton se bashkëshorti i subjektit, z. E.K, është subjekt rivlerësimi për shkak të ushtrimit të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

²Subjekti ka lidhur martesë me shtetasin E.K në datën 4.6.2007.

Tiranë. Komisioni, me vendimin nr. 2, datë 23.5.2022, ka vendosur administrimin e dokumentacionit për hetimin e kryer për pasurinë e z. E.K nga dosja hetimore e tij.

29. Në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, e dorëzuar në ILDKPKI në datën 25.1.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshorti E.K, kanë deklaruar:

30. Apartament me sipërfaqe 128.6 m², në S, Tiranë

Subjekti i rivlerësimit Mirela Kapo ka deklaruar në deklaratën *Vetting*: “*Blerë apartament me sip. 128.6 m², ndodhur në S, Tiranë, sipas kontratës së shitjes datë 20.5.2013. Si burim për blerjen e këtij apartamenti kanë shërbyer të ardhurat e grumbulluara nga pagat mujore të miat dhe të bashkëshortit, si dhe nga dhurata në shumën prej 85.000 euro nga ana e babait tim. Vlera: 85.764 euro*”. Bashkëlidhur me deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar dokumentacionin e fitimit, regjistrimit dhe burimit të krijimit të pasurisë³.

Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

30.1 Nga hetimi rezulton se subjekti i rivlerësimit Mirela Kapo e ka deklaruar për herë të parë pasurinë në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2015, në të cilën ka deklaruar: “*Blerje banese me sipërfaqe 128.6 m², në S, Tiranë, sipas kontratës së shitblerjes datë 20.5.2013. Si burim të ardhurash kanë shërbyer të ardhurat e përbashkëta bashkëshortore si dhe dhuruar shuma 85.000 euro nga babai i deklaruesit sipas deklaratës noteriale datë 25.6.2009*”.

30.2 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se subjekti i rivlerësimit Mirela Kapo dhe bashkëshorti E.K, me kontratë sipërmarrjeje të datës 20.4.2007, kanë porositur tek shoqëritë sipërmarrëse “S” sh.p.k. dhe “A” sh.p.k. apartamentin me sipërfaqe totale 147.52 m², kundrejt çmimit 85.764 euro. Palët kanë parashikuar në kontratë edhe mënyrën e kryerjes së pagesës. Kësti i parë prej 51.000 euro është paguar me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe kësti i dytë prej 34.764 euro do të likuidohet deri më 15.6.2007.

30.3 Me kontratë shitjeje pasuri e paluajtshme nr. ***, datë 20.5.2013, me palë blerëse E dhe Mirela Kapo dhe palë shitëse shoqëria “S” sh.p.k., është blerë apartamenti me sip. 128.6 m², regjistruar me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. **. Çmimi i përcaktuar në kontratë është 85.764 euro dhe sipas përmbajtjes së kontratës shuma është likuiduar tërësisht.

30.4 Nga hetimi rezultoi se⁴ shoqëritë sipërmarrëse/investitore “S” sh.p.k. dhe “A” sh.p.k. kanë lidhur me shtetasit Mirela dhe E Kapo kontratën nr. ***, datë 20.4.2007, për prenotimin e një apartamenti me strukturë 2+1 në objektin sipas lejes së ndërtimit nr. ***, datë 17.9.2004, miratuar nga Bashkia Tiranë. Shoqëria “S” sh.p.k., me përfundimin e punimeve dhe marrjen e lejes së shfrytëzimit nga Bashkia Tiranë pas hipotekimit të objektit, ka vazhduar shitjet përfundimtare sipas kontratave të sipërmarrjeve të lidhura më parë nga shoqëritë “S” sh.p.k dhe “A” sh.p.k. Shtetasit E dhe Mirela Kapo kanë lidhur kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 20.5.2013.

³Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 20.4.2007, kontratë shitjeje pasuri e paluajtshme nr. ***, datë 20.5.2013, me palë blerëse E dhe Mirela Kapo dhe shitës shoqëria “S” sh.p.k.

⁴Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.10.2021, nga shoqëria “S” sh.p.k., administruar nga dosja e subjektit të rivlerësimit E.K.

30.5 Nga hetimi rezultoi se duke kryer përlllogaritjet me çmimet⁵ e referencës sipas EKB-së në vitin 2007, çmimi i dakordësuar ndërmjet palëve për blerjen e pasurisë nuk rezultoi favorizues dhe/ose preferencial.

30.6 ASHK-ja⁶ konfirmon se pasuria apartament me sip. 128.6 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në S, Tiranë, figuron në bashkëpronësi të shtetasve Mirela dhe E. Kapo.

30.7 Nga hetimi rezultoi se⁷ në emër të personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, z. E.K, identifikohet një abonent në instancën Tiranë, sipas kontratës së lidhur në datën 30.5.2007 në kategorinë familjare me adresë: lagjja “****”, Tiranë.

Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë

30.8 Subjekti i rivlerësimit Mirela Kapo në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si burim krijimi për blerjen e pasurisë shumë 85.000 euro, të dhuruar nga babai i saj, shtetasi TH.K dhe shumë 764 euro si burim nga të ardhurat nga pagat⁸.

30.9 Në referim të pikës 14 të nenit 3 dhe nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016⁹, Komisioni vlerëson se babai i subjektit të rivlerësimit kategorizohet në cilësinë e personave të tjerë të lidhur, për të cilët subjekti i rivlerësimit ka detyrimin, bazuar në parimin e proporcionalitetit, justifikimin e ligjshmërisë së burimeve financiare, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumë 85.000, deklaruar si një nga burimet e pasurisë objekt vlerësimi.

30.10 Komisioni hetoi mbi mundësinë e krijimit me burime të ligjshme nga personi tjetër i lidhur, shtetasi TH.K, të shumë 85.000 euro.

Nga hetimi rezultoi se:

30.11 Me deklaratën noteriale të datës 25.6.2009, personi tjetër i lidhur, z. TH.K, deklaroi se në prill të vitit 2007 i dhuroi vajzës së tij, Mirela Kostaqi, shumë 85.000 euro, me qëllim blerjen e apartamentit objekt analize.

30.12 Z. TH.K,¹⁰ me vendimin e datës 25.5.1992 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, është regjistruar si person fizik.

30.13 Z. TH.K rezulton ortak¹¹ me 10% të kuotave në shoqërinë “****” sh.a., në periudhën 1998 – 19.1.2008, të cilat konvertohen në vlerën 3.000.000 lekë. Ai ka përfituar si aksioner

⁵Në zbatim të udhëzimit nr. 2, datë 4.4.2007, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit ‘K’, për vitin 2007”.

⁶Shkresë nr. *** prot., datë 4.2.2021.

⁷Shkresë nr. *** prot., datë 18.12.2020/kontratë furnizimi nr. ***, datë 30.5.2007.

⁸Deklaratë noteriale nr. ***, datë 25.6.2009, sipas së cilës z. TH.K deklaroi se në prill të vitit 2007 i dhuron vajzës së tij Mirela Kostaqi shumë 85.000 euro për blerjen e apartamentit; vërtetim nr. *** prot., datë 3.2.2016, nga shoqëria “****”, me të cilin vërtetohet se shtetasi TH.K, si aksioner i shoqërisë “****” sh.a., në periudhën 3.2.1999 – 31.12.2002, ka përfituar shumë 15.881.471 lekë.

⁹Pika 14, ligji nr. 84/2016 parashikon se “*persona të tjerë të lidhur*” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose Komisionerin Publik, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi”, ndërsa neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

¹⁰Bashkëlidhet me informacionin dhe ekstraktin e shoqërisë “****”, themeluar në datën 12.12.1998, me NIPT ***. QKB-ja përcjell, gjithashtu, edhe ekstraktin e shoqërisë kolektive me emrin tregtar “Dega e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër”, e themeluar në datën 8.7.1996, me administrator shtetasin TH.K.

¹¹QKB-ja bashkëlidhet me informacionin vendimin nr.*** akti, datë 30.12.1995, për regjistrimin e shoqërisë “****” sh.a., në të cilin konstatohet se shtetasi TH.K është ortak me 10% të aksioneve.

i kësaj shoqërie në formë dividendi për periudhën 3.2.1999 – 31.12.2002, shumën 15.881.471 lekë. Tatimi mbi dividendin është paguar nga shoqëria e sigurimeve “***” sh.a. dhe, në cilësinë e aksionerit të kësaj shoqërie, shtetasi TH.K ka përfituar shumën 1.630.140 lekë nga shitja e aksioneve, me marrëveshjen e datës 4.7.2007. Ndërsa në cilësinë e punonjësit të shoqërisë “***” sh.a. ka përfituar shumën 5.134.596 lekë, si të ardhura nga paga për periudhën 1.2.1999 – 1.2.2008.

30.14 Nga verifikimi i lëvizjeve në llogaritë bankare të shtetasit TH.K për periudhën 2000 – 2007, rezulton se kanë qarkulluar shuma të konsiderueshme fondesh në monedhat dhrahmi, euro dhe lekë, të cilat shpesh vinin edhe nga llogaria e tij bankare në Greqi.

30.15 Nga veprimet e lëvizjeve të llogarisë bankare në NBG Bank të shtetasit TH.K rezultoi se ka tërhequr: më 15.12.2006, vlerën 30.000 euro; më 20.4.2007, vlerën 10.000 euro; dhe më 14.6.2007, vlerën 30.000 euro.

30.16 Nga lëvizjet e llogarisë bankare në “Tirana Bank” të shtetasit TH.K rezultoi se ka tërhequr në datën 10.4.2007, shumën 14.000 euro dhe në datën 11.4.2007, shumën 5.000 euro. Këto shuma monetare kanë qenë depozitë bankare në “Tirana Bank” të krijuara ndër vite.

30.17 Nga hetimi ka rezultuar se z. TH.K ka pasur likuiditete në bankë, të cilat rezultojnë se janë tërhequr gjatë periudhës prill – qershor të vitit 2007. Këto të ardhura kanë rezultuar me burime të ligjshme nga aktiviteti i tij tregtar.

30.18 ISSH-ja¹² informoi se shtetasi TH.K në periudhën shtator 2016 – korrik 2018 ka përfituar pension invaliditeti në masën mujore 28.016 lekë dhe prej shtatorit 2016 përfiton pension pleqërie në masën 32.843 lekë. Shtetasja V.K, nëna e subjektit të rivlerësimit, prej korrikut të vitit 2015 përfiton pension pleqërie në masën mujore aktuale 26.411 lekë.

30.19 Lidhur me pagesën e shumës prej 764 euro për apartamentin, me burim të ardhurat e grumbulluara nga pagat mujore të subjektit dhe bashkëshortit, nga korrespondenca e Komisionit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve rezultoi se subjektit i kanë kaluar të ardhurat nga paga nga Prokuroria për Krimet e Rënda, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, si dhe pagesa nga University *** dhe universiteti “***” për periudhën 2015 e në vijim, nga të cilat rezultoi se kishte mundësi për krijimin e shumës 764 euro.

30.20 Lidhur me pagesën e shumës 764 euro për apartamentin me burimin tjetër të deklaruar për krijimin e kësaj pasurie, të ardhurat e grumbulluara nga pagat mujore të subjektit dhe bashkëshortit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dokumentacion mbi marrëdhënien e punësimit¹³ të saj dhe të bashkëshortit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹²Shkresë nr. *** prot., datë 14.12.2020, e ISSH-së.

¹³Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* në aneksin nr. 4/5 vërtetimet mbi marrëdhëniet e punësimit si: vërtetim datë 25.10.2016, nga shkolla e lartë universitare jopublike “***”; vërtetim page datë 11.10.2016, lëshuar nga fondacioni “***”; vërtetim datë 12.10.2016, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë; vërtetim nr. *** prot., datë 14.10.2016, nga ISSH-ja; të ardhurat nga barrëldja për periudhat 1.9.2007 - 28.2.2008 dhe 27.12.2010 - 20.10.2011; vërtetim nr. *** prot., datë 20.1.2017, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; *statement* bankar datë 20.10.2016 nga “Credins Bank”; të ardhura të përfituara nga kursi trajnues në Sicili, Itali, në shumën 68.749,52 lekë; vërtetim datë 4.1.2017, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; të ardhurat për periudhën janar 1998 e në vazhdim, në shumën 16.691.419 lekë.

30.21 Komisioni, duke u mbështetur në deklaratimet e subjektit dhe dokumentacionit provues ligjor, hartoi analizën financiare mbi mundësinë e kursimit nga subjekti me të ardhurat nga paga e saj dhe bashkëshortit deri në momentin e blerjes së pasurisë për krijimin e vlerës 764 euro, si diferencë e mbetur për t'u paguar për blerjen e apartamentit në çmimin 85.764 euro, në S, Tiranë. Referuar analizës financiare të kryer rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë pasur mundësi të kursejnë deri në qershor të vitit 2007 shumë 764 euro.

30.22 DPT-ja¹⁴ ka përcjellë ekstraktin historik të punonjësit për subjektin e rivlerësimit, sipas të cilit nga Prokuroria për Krimet e Rënda i ka kaluar paga për periudhën nëntor 2012 – nëntor 2015. Për periudhën nga muaji dhjetor 2015 e deri në muajin nëntor 2011 i ka kaluar pagë nga Prokuroria në Gjykatën e Shkallës së Parë Krujë. Në ekstraktin e përcjellë konstatohet se subjektit i janë kryer pagesa edhe nga University ***, universiteti “****”.

30.23 Për një hetim të plotë dhe gjithëpërfshirës lidhur me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi për shkak të funksionit, Komisioni iu drejtua Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë nëse nga subjekti i rivlerësimit shoqëria “S” sh.p.k. me administrator L.D shoqëria “A” sh.p.k., me administrator P.S, janë hetuar në cilësinë e të dyshuarit për kryerjen e veprës/veprave penale, është thirrur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, dëshmitar, i dëmtuar akuzues, viktimë në procedime apo kallëzime të hetuara nga subjekti i rivlerësimit. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë¹⁵ informon se nga verifikimi i bërë në regjistrat në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë nuk rezulton asnjë e dhënë që në këtë prokurori të jetë regjistruar ndonjë procedim penal apo të jetë marrë ndonjë vendim mosfillimi, pushimi ose dërguar në gjykatë nga prokurorja Mirela Kapo ose nga prokurorët e tjerë që ushtrojnë funksionin pranë kësaj prokurorie.

30.24 Nisur nga analizimi i provave të administruara gjatë hetimit administrativ, deklaratimet e subjektit përpara dhe gjatë hetimit administrativ, konstatimet e bëra me rezultatet e hetimit trupi gjykues vlerëson se personi tjetër i lidhur, babai i subjektit të rivlerësimit, shtetasi TH.K ka pasur burime të ligjshme për dhurimin e shumë 85.000 euro për blerjen e pasurisë me nr. ***, me sip. 128.6 m² e llojit “apartament”. Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë pasur mundësi financiare për krijimin e shumë 764 euro, diferencës së mbetur pas dhurimit të shumë 85.000 euro nga z. TH.K, për blerjen e pasurisë apartament me nr. ***, me sip. 128.6 m². Nga hetimi i Komisionit rezultoi se pasuria apartament banimi në S, Tiranë, është krijuar para fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit më 2.11.2015 dhe gjatë martesës me shtetasin E.K. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues çmon se nuk rezultojnë problematika në pasurinë nr. ***, apartament me sip. 128.6 m² dhe pasurinë nr. *** (shtesë) në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar me saktësi dhe vërtetësi në kuptim të kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

31. Rikonstruksioni i pjesshëm i sipërfaqes 23 m², i verandës së ballkonit të apartamentit të banimit në S, Tiranë

¹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 18.12.2020, nga DPT-ja.

¹⁵Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 13.4.2022, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Nga hetimi i Komisionit rezulton se subjekti e ka deklaruar për herë të parë pasurinë në deklaratën *Vetting*, ku deklaroi: “*Rikonstruksioni i pjesshëm i sipërfaqes prej 23 m² i verandës së ballkonit të apartamentit të banimit, periudha 2008 – 2013. Si burim të ardhurash kanë shërbyer kursimet e përbashkëta vjetore bashkëshortore (nuk disponoj fatura në lidhje me shpenzimet). Vlera: 500.000 lekë*”. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting* dokumentacionin e aplikimit për legalizimin dhe regjistrimin e pasurisë të depozituar në ZVRPP-në Tiranë¹⁶.

Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

31.1 Agjencia Shtetërore e Kadastrës¹⁷ informon Komisionin se subjekti dhe bashkëshorti, me kërkesën për legalizim datë 12.7.2013, kanë vetëdeklaruar ndërtim me përshkrimin “shtesë kati në S, Tiranë, me sip. 30 m²”. Për ndërtimin është lëshuar leje legalizimi në emër të subjektit dhe bashkëshortit në datën 23.8.2013 për objektin “shtesë kati në verandën ekzistuese”, me sip. 23 m².

31.2 Në dokumentacionin bashkëlidhur përgjigjes së ASHK-së konstatohet deklaratë noteriale nr. ***, datë 16.2.2016, “Për efekt të bashkimit të dy pasurive apartamentit dhe shtesës”, në të cilën bashkëshorti dhe subjekti kanë deklaruar se pasuria me nr. ***, apartament me vendndodhje në S, Tiranë, sipas certifikatës së pronësisë është 128.6 m². Me lejen e legalizimit datë 29.8.2013 është legalizuar një sipërfaqe, apartament prej 23 m², e cila është brenda sip. 128.6 m². Pra, sipërfaqja totale e apartamentit është 128.6 m², duke përfshirë të dyja pasuritë – apartament dhe shtesë. Sipas shënimit në kartelën e pasurisë rezulton se pasuria është regjistruar në ZVRPP në datën 11.9.2013.

31.3 Sa më sipër, Komisioni çmon se ky ndërtim është pjesë e apartamentit të banimit të blerë nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes në vitin 2007 nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti, sipas së cilës sipërfaqja e shfrytëzimit është 126.8 m², e ndarë në sipërfaqe banimi 78.87 m² dhe verandë 50 m². Ndërtimi me sip. 23 m², realizuar te veranda është pjesë e pandarë e sipërfaqes totale të apartamentit prej 126.08 m². Rezultoi e provuar se pasuria me sip. 128.6 m², nr. ***, z. k. *** dhe pasuria me nr. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 23 m² janë mbyllur dhe, në vijim të procedurës së regjistrimit në ZVRPP Tiranë, janë bashkuar në një pasuri të vetme, e cila mban numrin ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 128.6 m², në bashkëpronësi të shtetasve Mirela dhe E. Kapo.

32 Sa më sipër, në analizë të harmonizuar të të gjitha provave të administruara, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktësisht dhe në mënyrë të plotë dhe në përputhje me ligjin pasurinë në deklaratën *Vetting*. Kjo pasuri është është krijuar gjatë martesës me personin e lidhur, z. E.K, por para fillimit të detyrës nga subjekti në datën 2.11.2015. Në përfundim, Komisioni çmon se nuk rezultojnë problematika në kuptim të

¹⁶Aneks nr. 4/4, bashkëlidhur leje legalizimi nr. ***, datë 29.8.2013, shtesë kati në verandën ekzistuese, z. k. ***, nr. pasurie ***, sip. e ndërtimit 23 m², sip. për banim 23 m², numri i kateve mbi tokë 6+1. Planimetria e katit të gjashtë + genplan; deklaratë noteriale nr. ***, datë 16.2.2016, nga shtetasit E. dhe Mirela Kapo, drejtuar ZVRPP-së Tiranë, ku kërkohet bashkimi dhe korrigjimi i pasurive nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, apartament me sip. 23 m² dhe nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, apartament me sip. 128,6 m², pasi apartamenti me sip. 23 m² është brenda apartamentit me sip. 128.6 m²; certifikatë për vërtetim pronësie nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, apartament me sip. 128.60 m², në emër të shtetasve E. dhe Mirela Kapo me ½ pjesë secili, lëshuar në datën 17.2.2016.

¹⁷Shkresë nr. *** prot., datë 18.12.2020. Pasuria me nr. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 23 m², në kartelë në Seksionin B “Seksioni i përshkrimit të pasurisë” pasuria është e llojit apartament, rezulton në bashkëpronësi të shtetasve Mirela dhe E. Kapo. Pasuria është mbyllur dhe vijon në volum ***, faqe ***.

nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe se deklarimet e subjektit të rivlerësimit plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

33. Kartë krediti *mastercard*, me limit krediti 1.500 euro, marrë në “Raiffeisen Bank” në formën e kredisë – marrëveshja datë 14.6.2016

33.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*¹⁸ dokumentacionin e përfitimit të kartës së kreditit *mastercard*. “Raiffeisen Bank”¹⁹ përcjell në Komision se konfirmohet deklarimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me kartën e kreditit.

33.2 Trupi gjykues çmon se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit. Subjekti ka deklaruar me saktësi dhe vërtetësi përfitimin e kartës së kreditit *mastercard* dhe nuk rezultojnë problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

34. Në seksionin e të dhënave konfidenciale të deklaratës *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Dhënë pëlqimi për dhurimin e një sipërfaqeje prej 970 m² e llojit ‘arë’ nga ana e bashkëshortit tim, e cila ndodhet në fshatin L, të rrethit Tiranë, sipas kontratës së dhurimit nr. ***, datë 23.1.2015. Kjo sipërfaqe i është dhuruar personit të lidhur me subjektin deklarues sipas kontratës së dhurimit nr. *** kol., datë 13.11.1998”.*

Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

34.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*²⁰ përfitimin dhe tjetërsimet e kryera nga personi i lidhur, bashkëshorti E.K, të pasurisë arë me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 970 m², në L, Tiranë.

34.2 Sipas dokumentacionit të përcjellë nga ASHK-ja²¹ rezultoi se pasuria është fituar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. E.K, me nr. ***, datë 13.11.1998, me palë dhuruese shtetasit T, I, I dhe V.H.D, të cilët i kanë dhuruar shtetasit E.K një sipërfaqe toke prej 970 m², z. k. ***, me vendndodhje të pasurisë në L, Tiranë. Pasuria është fituar nga pala dhuruese me AMTP-në datë 30.6.1992, nga shtetasi F.D, në cilësinë e kryetarit të familjes bujqësore. Pasuria është e regjistruar në ZVRPP-në Tiranë dhe bashkëshorti i subjektit për pasurinë me nr. ***, me sip. 970 m², e llojit “arë” është pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie më 26.11.1998.

34.3 Me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 23.1.2015, kjo pasuri dhurohet nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit shtetases D.K, e cila e ka regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në mars të vitit 2015. Lidhur me dhurimin e kësaj pasurie shtetases D.K, bashkëshorti i subjektit të

¹⁸Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së: nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, datë 20.1.2017. Balanca 0 (zero) lekë. Fatura e kartës së kreditit, limiti i kartës 1.500 euro. Gjendja e llogarisë në datën 30.9.2016 është -0.02 euro, detyrimi për t’u paguar 0 (zero) lekë. Marrëveshje mbi përdorimin e kartës individuale të kreditit datë 6.6.2016.

¹⁹Shkresë nr. *** prot., datë 21.12.2020, nga RBAL Bank.

²⁰Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së: kontratë dhurimi nr. ***, datë 13.11.1998, me palë dhuruese F, T, I, I dhe V. H. D. me objekt dhurimin e një sipërfaqeje toke 970 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***, me adresë të pasurisë L, Tiranë; kontratë dhurimi nr. ***, datë 23.1.2015 me objekt dhurimin e pasurisë së paluajtshme Arë me sipërfaqe 970 m² me adresë L, Tiranë, me përfitues të dhurimit shtetasen D.K. Pasuria është e regjistruar në ZVRPP-në Tiranë dhe bashkëshorti i subjektit është pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie më 26.11.1998, për pasurinë me nr. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 970 m², e llojit “arë”.

²¹Shkresë nr. *** prot., datë 30.12.2020, nga ASHK-ja.

rivlerësimit ka shpjeguar gjatë procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni për të, se nisur nga lidhjet e ngushta familjare që familja e tij e origjinës kishte me këtë shtetase, ai dhe familja e tij nuk do të kryenin asnjë investim mbi sipërfaqen prej 970 m² apo të zhvillonin pronën, si dhe faktin se shtetasja D.K kishte ndërtimin²² e saj në një pjesë të kësaj pasurie, vendosi t’ia dhurojë këtë sipërfaqe toke me qëllim shfrytëzimin prej saj në shërbim edhe të banimit.

34.4 Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues, mbështetur në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit, vlerëson se ato përputhen me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit të Komisionit. Pasuria është fituar para martesës së subjektit të rivlerësimit Mirela Kapo me shtetasin E.K dhe është tjetërsuar/dhuruar para fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se nuk ka të dhëna për pavërtetësi apo fshehje pasurie në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

35. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting*: “Shtuar depozita bankare në ‘Intesa Sanpaolo Bank’, në emrin tim, e çelur më 8.1.2002, në shumën 4.000 USD. Si burim të ardhurash kanë shërbyer kursimet e mia nga të ardhurat vjetore shuma 833,66 USD”.

Personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dokumentacionin ligjor të krijimit dhe gjendjes së depozitës në datën 10.1.2017²³.

35.1 “Intesa Sanpaolo Bank” informon²⁴ Komisionin se gjendja e depozitës së kursimit në datën e çeljes, 31.12.2003, ka qenë 4.072 USD, e cila është mbajtur si depozitë kursimi deri në datën e tërheqjes, 24.7.2018, ku ka pasur vlerën 4.844 USD. Në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting*, 26.1.2017, shuma e depozitës së kursimit është 4.836,48 USD.

35.2 Komisioni hetoi mbi mundësinë e krijimit të vlerës së krijimit të depozitës në vlerën 4.000 USD dhe hartoi analizën financiare, sipas së cilës rezultoi se bashkëshorti ka pasur mundësi për krijimin e saj me të ardhura të ligjshme.

Analiza financiare	1.1.1998 - 8.1.2002 (vlerat në lekë)
Të ardhura nga paga si OPGJ në vitet 1998 - 1999 e në vazhdim si prokuror	1 651 922
Vlera e depozitimit për krijimin e depozitës së kursimit (4.000 USD)	539 865
Shpenzime jetese	428 745
Rezultati financiar	683 313

²²Sipas dokumentacionit të ASHK-së rezultojnë se pasuria aktualisht është regjistruar me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. *** dhe ka sipërfaqe totale 970 m², e ndarë në 300 m² truall dhe 99.03 m² ndërtesë, në pronësi të shtetasës D.K. Në dokumentacionin e përcjellë rezultojnë se shtetasja D.K është pajisur me leje legalizimi nr. ***, datë 27.3.2015, për objekt me sipërfaqe ndërtimi 99.3 m², sipërfaqe banimi 99.3 m², numri kateve1.

²³Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së; vërtetim nga Banka Amerikane e Shqipërisë, datë 8.1.2002, për çeljen e depozitës prej 4.000 USD, në emër të shtetasit E.K; formular pozicioni i klientit, lëshuar nga “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 10.1.2017, konfirmohet depozitë në emër të shtetasit E.K, në monedhën USD, me gjendje 4.833,66 USD.

²⁴Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 18.12.2020, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

35.3 Trupi gjykues, në analizë të sa më sipër, arrin në konkluzionin se pasuria e personit të lidhur/bashkëshorti i subjektit E.K është krijuar para martesës me znj. Mirela Kapo dhe para fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit në nëntor të vitit 2015. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se nuk ka problematika për këtë pasuri, në këndvështrim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* disa pasuri të krijuara para fillimit të detyrës si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

36. Automjetet me targa *, sipas kontratës datë 23.4.2009**

Si burim për blerjen e këtij automjeti kanë shërbyer të ardhurat e grumbulluara nga shitja e automjetit në emër të bashkëshortit të subjektit, me targa ***, në bazë të kontratës së datës 18.5.2009. Nga shitja e automjetit në emër të subjektit deklarues me targa ***, në bazë të kontratës datë 23.4.2009, si dhe nga të ardhurat e grumbulluara nga pagat mujore të subjektit dhe bashkëshortit. Aktualisht, automjeti me targa ***, disponon targën ***. Vlera: 15.150 euro.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dokumentacionin e fitimit dhe tjetërsimet e kryera të pasurisë automjetet me targa ***²⁵.

Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

36.1 Nga hetimi rezulton se subjekti në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës së vitit 2015 ka deklaruar *shitje automjeti me targa ***, regjistruar në emër të deklarueses sipas kontratës së shitblerjes datë 23.4.2009*, ndërsa bashkëshorti i subjektit ka deklaruar *blerje automjeti me targa ***, sipas kontratës së datës 1.6.2009*. Si burim të ardhurash kanë shërbyer kursimet e përbashkëta bashkëshortore, si dhe nga përfitimi i shitjes së automjetit me targa ***, regjistruar në emrin e tij dhe ai me targa ***, regjistruar në emër të bashkëshortes.

36.2 Komisioni iu drejtua DPSHTRR-së për të vënë në dispozicion dosjen e automjetit. Sipas përgjigjes së DPSHTRR-së²⁶ rezultoi se me kontratën e shitblerjes së automjetit datë 1.6.2009, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. automjetin tip “Skoda”, në vlerën 15.150 euro.

36.3 Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie të luajtshme, Komisioni kreu hetimin sipas deklaramit të subjektit të rivlerësimit, ku si burim për blerjen e automjetit me targa ***/*** kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjeteve ***, në vlerën 5.000 euro²⁷ dhe ***, në vlerën 400.000 lekë²⁸, si dhe të ardhurat e grumbulluara nga pagat mujore të saj dhe të bashkëshortit. Sipas hetimit të Komisionit rezulton se pasuria është krijuar para fillimit të

²⁵Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së; kontratë shitblerjeje automjeti datë 1.6.2009, tip “Skoda Roomster style 1.9 TDI” në vlerën 15.150 euro, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë blerëse E.K; certifikatë pronësie mjeti rrugor me targa ***, në emër të E.K, vit prodhimi 2008, regjistruar në datën 28.5.2012; kontratë shitjeje nr. ***, datë 23.4.2009, palë shitëse Mirela Kostaqi dhe palë blerëse E.A, për automjetin tip “Opel Corsa”, me targa ***, në vlerën 400.000 lekë; kontratë shitjeje nr. ***, datë 18.5.2009, palë shitëse E.K dhe palë blerëse E.S, për automjetin tip “Volkswagen Passat”, me targa ***, në vlerën 5.000 euro.

²⁶Shkresë nr. *** prot., datë 26.4.2022, nga DPSHTRR-ja.

²⁷Me kontratën datë 18.5.2009 ka shitur automjetin me targa ***, në vlerën 5.000 euro.

²⁸Automjeti është importuar nga shteti italian dhe është zhdoganuar nga shtetasi I.O më 7.7.2003, nga pika kufitare e Kapshticës. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit më 15.7.2003 ka kryer kontrollin fizik të automjetit tip “Volkswagen Passat TDI”, numër shasie ***, vit prodhimi 2002.

detyrës nga subjekti i rivlerësimit Mirela Kapo dhe bashkëshorti, të cilët kanë pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

36.4 Për një hetim të plotë dhe gjithëpërfshirës lidhur me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi për shkak të funksionit, Komisioni iu drejtua Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë nëse shtetasi E.S është hetuar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e të dyshuarit për kryerjen e veprës/veprave penale apo është thirrur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, dëshmitar, i dëmtuar akuzues, viktimë në procedime apo kallëzime të hetuara nga subjekti i rivlerësimit. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë²⁹ informoi se nga verifikimi i bërë në regjistrat në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë nuk rezultoi asnjë e dhënë që në këtë prokurori të jetë regjistruar ndonjë procedim penal apo të jetë marrë ndonjë vendim mosfillimi, pushimi ose dërguar në gjykatë nga prokurorja Mirela Kapo ose nga prokurorët e tjerë që ushtrojnë funksionin pranë kësaj prokurorie në emër të E.S.

36.5 Komisioni, gjatë hetimit, konstatoi se subjekti ka një pasaktësi në datën e deklarimit të blerjes së automjetit me targa *** në deklaratën *Vetting*, për të cilin deklaroi se është blerë në datën 23.4.2009, ndërsa nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit rezultoi se automjeti është blerë në datën 1.6.2009.

Për sa më sipër, në kushtet kur nuk ka dyshime mbi mënyrën e fitimit dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie, trupi gjykues çmon se kjo pasaktësi në deklaram nuk ndikon në vendimmarrjen përfundimtare të Komisionit dhe nuk ka efekt penalizues për dhënie masë disiplinore sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

37. Përfitim kredi bankare, në vlerën 3.250.000 lekë me përfitues babain e bashkëshortit të subjektit, z. P.K, si qiramarrës në banesat ish-pronë private

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting*: “*Përfitim kredie bankare në vlerën prej 3.250.000 lekë në emër të babait të personit të lidhur me subjektin deklarues, si dhe të subjektit deklarues. Kjo kredi është përfitur nga babai i personit të lidhur me subjektin deklarues, si qiramarrës në banesat ish-pronë private, sipas kontratës së datës 13.7.2013, nr. ***. Sipas kësaj kontrate, norma e interesit do të jetë bono thesari 1-vjeçare + 2.2% mbi bazë vjetore. Kjo kredi është akorduar për 360 muaj dhe shlyhet prej babait të personit të lidhur me subjektin deklarues. Shuma e detyrimit financiar të mbetur pa shlyer deri në datën e rivlerësimit: 2.879.861,02 lekë*”.

Subjekti i rivlerësimit Mirela Kapo i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*³⁰ dokumentacionin justifikues ligjor të përfitimit të kredisë, destinacionit të përdorimit dhe gjendjen e mbetur pa likuiduar deri në datën 4.1.2017.

Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

²⁹Shkresë nr. *** prot., datë 13.4.2022.

³⁰Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së; kontratë kredie bankare nr. ***, data 13.7.2013, kredihënës Banka Kombëtare Tregtare dhe kredimarrës P.K, E.K, Mirela Kapo. Shuma e kredisë 3.250.000 lekë me afat 360 muaj dhe do përdoret për blerje shtëpie; deklaratë noteriale nr. ***, datë 22.7.2013, e shtetasve P.K dhe F.K, për lirimin dhe dorëzimin e shtëpisë ku kanë jetuar, pronarit të ligjshëm; certifikatë për vërtetim pronësie, me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, apartament me sip. 114.10 m², në emër të shtetasit P.K, lëshuar në datën 11.3.2013; vërtetim nr. *** prot., data 4.1.2017, lëshuar nga BKT. Vërtetohet kredi e marrë nga shtetasi P.K.

37.1 Subjekti i rivlerësimit në DIPP/2016 ka deklaruar: *“Përfitim kredie bankare në vlerë prej 3 250 000 lekë në emër të babait të bashkëshortit të subjektit deklarues dhe bashkëshortit të subjektit deklarues. Kjo kredi është përfituar nga babai i bashkëshortit të subjektit deklarues si qiramarrës në banesat ish-pronë private, sipas kontratës së datës 13.7.2013, nr. ***. Sipas kësaj kontrate, norma e interesit do të jetë bono thesari 1-vjeçare + 2.2% mbi bazën vjetore. Kjo kredi është akorduar për 360 muaj dhe nga babai i bashkëshortit të subjektit deklarues. Si kolateral për këtë kredi është vënë apartamenti në pronësi të babait të bashkëshortit deklarues”*.

37.2 Në përgjigje të pyetjes³¹ nga Komisioni nëse ka marrë ndonjëherë hua nga ndonjë shoqëri private apo publike, subjekti i rivlerësimit Mirela Kapo ka shpjeguar se ajo dhe bashkëshorti janë bashkëkredimarrës në kredinë bankare në vlerën 3.250.000 lekë pranë BKT-së, me kontratë të datës 13.7.2013. Kredia është përfituar në emër të shtetasit P.K, vjehrrit të subjektit, i cili kishte statusin e ish-qiramarrësit në banesat ish-pronë private³². Subjekti ka vijuar me shpjegimet se kredia është mbyllur në prill të vitit 2020, këstet e kredisë janë shlyer tërësisht nga vjehri i subjektit, z. P.K, dhe subjekti e bashkëshorti nuk kanë paguar asnjë nga këstet e kësaj kredie. Mbi statusin si bashkëkredimarrës në këtë kredi, ka shpjeguar se ishte një kërkesë e bankës për të garantuar shlyerjen e kredisë për shkak të moshës së madhe të z. P.K në kohën e përfitimit të kredisë.

37.3 Nga hetimi rezultoi se babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit gëzon statusin e ish-qiramarrësit në ish-pronë private dhe, në zbatim të udhëzimit nr. 6257, datë 2.9.2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuar nga shteti”, ka dorëzuar dhe plotësuar dokumentacionin pranë Entit Kombëtar të Banesave për të përfituar dhe për t’u trajtuar nga kreditimi me kushte lehtësuese. Bashkia Tiranë ka konfirmuar përfitimin dhe trajtimin me kredi lehtësuese të shtetasit P.K.

37.4 Enti Kombëtar i Banesave³³ informon dhe përcjell në Komision dosjen e përfitimit të kredisë dhe marrëdhënien me EKB-në. Sipas praktikës bashkëlidhur konstatohet se me kërkesën drejtuar Entit Kombëtar të Banesave, datë 22.9.2009, z. P.K ka dorëzuar dokumentacionin për përfitim kredie të lehtësuar nga shteti në zbatim të kërkesave ligjore të udhëzimit nr. 6257, datë 2.9.2008.

37.5 Me shkresën nr. *** prot., datë 30.8.2010, “njoftim”, të Bashkisë Tiranë shtetasi P.K është njoftuar për përfitimin e kredisë me 0% për një periudhë 360 muaj dhe për t’u paraqitur pranë Bankës Kombëtare për të vijuar procedurat e mëtejshme.

37.6 BKT-ja³⁴ konfirmoi se me kontratë kredie bankare nr. ***, datë 13.7.2013 dhe kredimarrës P.K, E.K dhe Mirela Kapo është marrë kredi në shumën 3.250.000 lekë me afat 360 muaj, e cila do të përdoret për blerje shtëpie. Detyrimi i mbetur: 2.879.861 lekë. Sipas

³¹Shkresë kthim përgjigjeje pyetja nr. 19 në pyetësorin standard.

³²ILDKPKI-ja, në kuadër të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, ka përcjellë në Komision shpjegimet e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, së bashku me dokumentacionin përkatës, të mbajtur në procesverbalin e datës 5.2.2016, sipas të cilit bashkëshorti i subjektit, i pyetur nga ILDKPKI-ja, ka shpjeguar se në vitin 1992 janë vënë në dijeni se vila ku banonin i ishte kthyer pronarit nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe sipas ligjit të kohës u regjistrua si i pastrehë.

³³Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 19.10.2017, nga EKB-ja, administruar nga dosja hetimore e subjektit të rivlerësimit E.K.

³⁴Shkresë nr. *** prot., datë 23.9.2020, e BKT-së, e administruar nga dosja e personit të lidhur.

informacionit të BKT-së³⁵ shtetasi P.K, pas disbursimit të kredisë, ka transferuar nëpërmjet kësaj banke në datën 1.8.2013 në emër të shoqërisë “B.K” sh.p.k., vlerën 3.250.000 lekë dhe në vijim ka paguar rregullisht këstin e kredisë.

37.7 Sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 28.2.2013, me palë shitëse shoqërinë “L” sh.p.k dhe palë blerëse P. K., ka blerë pasurinë apartament me numër ***, me sipërfaqe 114.10 m², në vlerën 37 800 USD. Pasuria është regjistruar në ZVRPP në datën 11.3.2013 në emër të shtetasit P.K.

37.8 Në shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit, nënshkrimi i kontratës së kredisë nga ana e subjektit është bërë për të garantuar shlyerjen e detyrimeve nga ana e babait të bashkëshortit, i cili në periudhën e përfitimit të kësaj kredie ishte në moshë pleqërie.

37.9 Në vlerësim të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit rezulton se përputhen shpjegimet e subjektit me të dhënat e rezultuara nga korrespondenca e Komisionit me institucione publike dhe private mbi kredimarrjen nga vjehri i subjektit P.K.

37.10 Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues çmon se deklarimi i subjektit në kuptim të procesit të rivlerësimit është në përputhje me dokumentacionin dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ dhe nuk paraqiten problematika në këndvështrim të ligjit 84/2016, “ Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Analiza financiare e vitit 2015 - 2016

38. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, si dhe në deklaratimet periodike vjetore ndër vite, duke përfshirë të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet dhe detyrimet, nga përlllogaritja e tyre është vlerësuar dhe konkluduar mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të kursyera, me të ardhurat nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Në konkluzion, pasi janë analizuar dhe vlerësuar nga trupi gjykues edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, pasi janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat, duke filluar nga viti 2015, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i subjektit në ILDKPKI, deri në vitin 2016, si rezultat i përgjithshëm vjetor dhe përfundimtar, ka rezultuar me një bilanc të përgjithshëm në vlerë pozitive prej 2.502.091 lekësh. Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacionin justifikues ligjor, si dhe analizoi qëndrimin e subjektit në seancën dëgjimore për rezultatin e analizës financiare.

39. Trup gjykues çmon se, bazuar në analizën financiare, subjekti ka pasur mundësi të krijojë pasuritë ose/dhe të kryejë shpenzimet e deklaruara me të ardhura të ligjshme për periudhën nëntor 2015 - 2016, e cila është me vlerë pozitive.

³⁵Shkresë nr. *** prot., datë 15.12.2020, nga BKT.

Analiza financiare e vitit 2015 – 2016

Përshkrimi	Nentor 2015	2016
PASURI	17 052	-91 731
Blerë apartament me sipërfaqe 128.6 m2, ndodhur në S***, T***, sipas kontratës së shitjes datë 20.05.2013. Si burim për blerjen e këtij apartamenti kanë shërbyer të ardhurat e grumbulluara nga pagat mujore të mia dhe të bashkëshortit, si dhe nga dhurata në shumën prej 85.000 Euro nga ana e babait të subjektit deklarues. Vlera 85.764 Euro.		
Automjet me targë TR***, në bazë të kontratës së datës 23.04.2009. Si burim për blerjen e këtij automjeti kanë shërbyer të ardhurat e grumbulluara nga shitja e automjetit në emër të bashkëshortit tim, me targë TR***, në bazë të kontratës së datës 18.05.2009; nga shitja e automjetit në emër të subjektit deklarues me targë TR***, në bazë të kontratës së datës 23.04.2009, si dhe nga të ardhurat e grumbulluara nga pagat mujore të mia dhe të bashkëshortit. Vlera 15.150 euro.		
Rikonstruksion i pjesshëm i sipërfaqes prej 23 m2, i verandës së ballkonit të apartamentit të banimit, periudha 2008-2013. Si burim të ardhurash kanë shërbyer kursimet e përbashkëta vjetore bashkëshortore (nuk disponoj fatura në lidhje me shpenzimet e kryera). Vlera 500.000 lekë.		
Dhënë pëlqimi për dhurimin e një sipërfaqe prej 970 m2 e llojit arë nga ana e bashkëshortit tim e cila ndodhet në fshatin L***sipas kontratës së dhurimit datë 23.01.2015. Kjo sipërfaqe i ishte dhuruar personit të lidhur me subjektin deklarues sipas kontratës së dhurimit nr.***K01, datë 13.11.1998.		
Shtesa/pakësime likuiditete në bankë	17 052	-91 731
Total likuiditete	717 400	625 669
DETYRIME	0	0
Kredi bankare në vlerën prej 3.250.000 lekë, në emër të babait të personit të lidhur me subjektin deklarues. Shuma e detyrimit financiar të mbetur pashlyer deri në datën e rivlerësimit: 2.879.861,02 lekë.		
Përfitimi kartë krediti “M*** Card” me limit krediti 1.500 Euro, marrë në Bankën “R*** Bank”. Marrëveshja datë 14.06.2016.		
PASURI NETO	17 052	-91 731
TË ARDHURA dokumentuar	2 273 735	2 330 534
Paga vjetore e subjektit deklarues, nga muaji prill 2005 deri në muajin nëntor 2015, si sekretare dhe më pas oficer e policisë gjyqësore. Shuma e të ardhurave neto të krijuara 7.566.386 lekë.	853 889	
Paga vjetore e subjektit deklarues nga muaji nëntor 2015 deri më 31.12.2016, si prokurore. Shuma e të ardhurave neto të krijuara 1.198.508 lekë.	167 457	1 043 280
Të ardhurat e subjektit deklarues nga mësimdhënia si pedagogje e jashtme në Fakultetin e Drejtësisë “L****” për periudhën janar 2005 - dhjetor 2014. Shuma e të ardhurave neto të krijuara 422.639 lekë.		
Të ardhurat e subjektit deklarues nga mësimdhënia si pedagogje e jashtme në Universitetin “Z*** e K*** të M****” për periudhën janar 2006 - qershor 2008. Shuma e të ardhurave neto të krijuara 1.090,8 Euro.		
Paga vjetore e bashkëshortit, nga muaji janar 1999 deri në datë 31.12.2016, si oficer i policisë gjyqësore dhe më pas prokuror. Shuma e të ardhurave neto të krijuara 16.691.422 lekë.	1 251 376	1 286 484
Përfituar shpërblim nga ambasada e Sh** për pjesëmarrje në kursin trajnues në S***, I*** në Korrik 2014. Shuma e të ardhurave neto të krijuara 68.749,52 lekë.		
Te ardhura nga shitja e automjetit me targë TR *** sipas kontrates se shitjes date 23.04.2009.		
Të ardhura nga interesat e depozitës pranë I*** Bank	1 013	770
SHPENZIME	735 158	1 345 554
Shpenzime arredimi	50 000	50 000
Shpenzime jetike	149 517	940 368
Shpenzime udhëtimi	535 641	355 186
Analiza dokumentuar	1 521 525	1 076 711

Konkluzione përfundimtare për kriterin e pasurisë

Komisioni, në përfundim të këtij hetimi administrativ, çmon se në vendimmarrjen e tij përfundimtare, siç konstatohet edhe më lart, duhet të marrë në konsideratë, si vijon:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj dhe të personave të lidhur me të, siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të saj.
- iii. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Mirela Kapo ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

40. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 31.10.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Mirela Kapo, të deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 5.02.2021, të KDZH-së. Sipas këtij raporti, formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka gjeneralitete si ato të deklaruara prej saj në deklaratën për kontrollin e figurës; dhe për subjektin nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

41. Në konkluzion, Grupi i Punës ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Mirela Kapo.

42. Komisioni iu drejtua Prokurorisë së Përgjithshme³⁶ dhe Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar³⁷ me kërkesën për informacion në lidhje me *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve për përfshirjen e subjektit drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, që cenojnë figurën e saj. Prokuroria e Përgjithshme përcolli informacionin e ardhur nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, nga të cilat nuk rezultoi të jetë regjistruar apo mosfilluar procedim penal në emër të subjektit të rivlerësimit.

43. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar sqaroi se pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale të Prokurorisë së Posaçme

³⁶Shkresë nr. *** prot., datë 12.7.2021, e Prokurorisë së Përgjithshme.

³⁷Shkresë nr. *** prot., datë 14.6.2022, e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe në atë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, rezulton se ndaj shtetasve Mirela Kapo është regjistruar procedimi penal me nr. *** i vitit 2017, aktet penale të të cilit i përcjell bashkëlidhur shkresës në Komision.

43.1 Nga aktet e kallëzimit penal nr. *** të vitit 2017, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda, rezulton se në portalin online “****” të Kryeministrit është paraqitur një ankesë ndaj prokurores Mirela Kapo, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Kjo ankesë i është përcjellë Ministrit të Drejtësisë, e cila për shkak kompetence lëndore ka përcjellë materialin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda për hetime të mëtejshme. Në këtë ankesë pretendohet se prokurorja Mirela Kapo gjatë kryerjes së detyrës në hetimin penal të shtetasve F.SH, me detyrë ish-drejtor i Hipotekës Krujë dhe M.RR ish-sekretar i komunës Thumanë, i ka favorizuar, duke iu caktuar masa e sigurimit “arrest në shtëpi”, veprim ky i pretenduar i kryer kundrejt rryshfetit. Nga verifikimi i letrës denoncuese rezulton se është një dokument ankesë anonime, pasi nuk jepen gjeneralitetet e personit që bën denoncimin e faktit. Pas verifikimeve nuk është bërë i mundur identifikimi i denoncuesit për të mundësuar marrjen e të dhënave nga personi. Referuar nenit 283/3 të Kodit të Procedurës Penale kallëzimet anonime nuk mund të përdoren, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 194 i Kodit të Procedurës Penale, kur këto dokumente anonime përbëjnë provë materiale ose janë bërë nga i pandehuri, gjë që në rastin konkret nuk ekziston asnjë nga rastet e parashikuara në ligj.

43.2 Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda ka kryer verifikimet e akteve procedurale dhe ka rezultuar se në datën 16.9.2016 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit A.L, ka regjistruar procedimin penal nr. **, për veprat penale “shpërdorim detyre” dhe “falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga nenet 248 dhe 186 të Kodit Penal dhe ka komunikuar e dërguar për gjykim të pandehurit F.SH dhe M.RR, të cilët gjykohen me masën e sigurimit personal, atë të “detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “arrestit në shtëpi”. Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, prokurorët dhe gjyqtarët gjatë kryerjes së detyrës janë të pavarur dhe i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi. Nisur nga sa më lart, duke iu referuar edhe pretendimeve të parashtruara në kallëzim, nuk evidentohet asnjë *indicie*, fakt apo provë që mund të përbëjë dyshim të arsyeshëm mbi ekzistencën e elementeve të veprës penale të parashikuar nga nenet 319 dhe 319/ç apo të ndonjë vepre tjetër penale të kryer nga prokurori apo gjyqtarët e çështjes penale kundër shtetasve F.SH dhe M.RR. Ndodhur në këto rrethana dhe nga analiza në tërësi e akteve të dosjes penale, objektit dhe pretendimit të parashtruar nga denoncuesi i paidentifikuar në kallëzim, subjekti i rivlerësimit Mirela Kapo, në cilësinë e prokurores së çështjes, ka arritur në përfundimin se fakti penal nuk ekziston, rrethana ligjore e cila nuk lejon fillimin e procedimit penal. Dhe, për këtë arsye, në datën 12.10.2017 ka vendosur mosfillimin e hetimeve në lidhje me denoncimin e ardhur nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 14.8.2017, të Ministrit të Drejtësisë, për shkak se fakti penal nuk ekziston.

43.3 Për rrjedhojë, në vijim të komunikimeve me organet ligjzbatuese dhe përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni nuk kanë rezultuar informacione apo fakte/rrethana të

reja për subjektin e rivlerësimit lidhur me këtë kriter, që mund të ngrinin dyshime mbi bazueshmërinë e konkluzioneve të arritura nga DSIK-ja, si më lart.

43.4 Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Mirela Kapo ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

44. Në zbatim të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Mirela Kapo, bazuar në raportin për analizimin e aftësisë profesionale, dorëzuar në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 22.9.2021, nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. ***, datë 18.5.2021, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit është vlerësuar pozitivisht për aftësitë profesionale. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rregulloren “Për vlerësimin etik e profesional të subjekteve në proces rivlerësimi”, ka miratuar raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike për përkrimin dhe analizën e dokumenteve të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit Mirela Kapo, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, aktualisht me funksion ndihmës magjistrat në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi shumë të mira në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi. Subjekti ka njohuri të plota rreth instituteve të së drejtës penale. Ai shfaq njohuri të mira edhe në drejtim të kuptimit dhe zbatimit të normave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Në vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit, për vitet 2015 dhe 2016, të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm, rezultoi se për aftësitë profesionale, në cilësinë e prokurorit, është vlerësuar “shumë mirë”.

b) Arsyetimi ligjor

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga prokurori dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara evidentohet se subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Në aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se nga ana e tij bëhet analizë mbi rrethanat e faktit, si dhe faktet që janë konstatuar nga kontrolli në cilësinë e prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe provave të mbledhura, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore të çështjeve në ndjekje të praktikave përkatëse.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Sipas të dhënave rezulton se për periudhën e punës si prokurore, për periudhën 2.11.2015 – 8.10.2016, ka trajtuar gjithsej 140 çështje, duke përfshirë edhe ato për të cilat është vendosur pezullimi i hetimeve. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar më 17.12.2019, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë, për përzgjedhjen e pesë dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016 rezulton se nga ana e prokurores Mirela Kapo tregohet vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara. Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit Mirela Kapo kryen veprime procedurale hetimore, të cilat rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet që veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat dhe aktet e nevojshme dhe duke konkluduar në vendimmarrje.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Prokurorja Mirela Kapo ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave nuk konstatohen të dhëna për etikën në punë të prokurores Mirela Kapo. Gjithashtu, sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore për prokurorin, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor. Rezulton se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nuk rezulton të ketë pasur ankesa që nga subjekti të jenë kryer veprime apo mbajtur qëndrime të tilla jo në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Mirela Kapo dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e rëna në short, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Nga tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjet e rëna në short vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit Mirela Kapo të Prokurorit të Përgjithshëm, që i përkasin punës së saj për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “shumë mirë”.

c) Gatishmëria për t’u angazhuar

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t’u angazhuar, subjekti i rivlerësimit rezulton se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh³⁸ me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, si dhe rezulton të ketë marrë pjesë në disa aktivitete profesionale.

45. Duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formular, si dhe të dhënave në Drejtorinë Ekonomike dhe të Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë konstatohet se:

- Me urdhrin nr. ***, të Prokurorit të Përgjithshëm, është emëruar oficer e policisë gjyqësore për periudhën 2.6.2006 – 3.11.2015 në sektorin e ekzekutimit të letërporosive dhe marrëdhënieve me autoritetet gjyqësore në Prokurorinë e Krimeve të Rënda.
- Me Dekretin nr. ***, datë 2.11.2015, të Presidentit të Republikës, znj. Mirela Kapo është emëruar prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fushë -Krujë.
- Me vendimin nr. ***, datë 22.2.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, znj. Mirela Kapo është komanduar në pozicionin e këshilltarit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për një periudhë 1-vjeçare.

³⁸Tryezë e rumbullakët “Roli i sistemit të drejtësisë në mbrojtjen dhe promovimin e standardeve të barazisë dhe mosdiskriminimit gjinor. Roli i Shkollës së Magjistraturës përmes programit të trajnimit vazhdues, vlerësim i nevojave në këto aspekte. “Zhvilluar në datën 17.12.2015. Prezantimi i mode/it Kroat i Zyrës së Prokurorisë për Shtypjen e Korrupsionit dhe Krimin e Organizuar, kontrolli i sigurisë për gjyqtarët dhe prokurorët. Zhvilluar në datën 30.3.2016. Zbatimi i drejtpërdrejtë i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave. Roli i Gjykatës dhe sistemit të drejtësisë. Zhvilluar më 25.10.2016.

- Me vendimin nr. ***, datë 4.3.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, znj. Mirela Kapo është komanduar në pozicionin e ndihmës magjistratit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për një periudhë 5-vjeçare.

C/1. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI

46. Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit³⁹, pesë dosjet penale të përzgjedhura me short⁴⁰, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Pas verifikimit të raportit, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional.

DENONCIME

47. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur nga publiku tri denoncime⁴¹, të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse dhe janë administruar disa akte/dosje hetimore⁴² dhe gjyqësore për të vlerësuar aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit Mirela Kapo. Komisioni, me qëllim të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi me objektivitet të gjitha denoncimet e depozituara, nga verifikimet e të cilave kreu hetime shtesë duke iu drejtuar edhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për aktet përkatëse të procedimeve penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurores së çështjes e për të cilat denoncuesit ngrinin pretendimet e tyre në denoncim.

Denoncimi nr.* prot., datë 12.10.2018, i shtetasit P.A**

47.1 Shtetasi P.A pretendoi në denoncimin e tij se nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk janë kryer hetime të plota në kallëzimin e depozituar prej tij në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë ndaj kryeregjistruesit të ZVRPP-së Krujë, veprimet hetimore të të cilit janë ndjekur nga subjekti i rivlerësimit si prokurore e çështjes. Denoncuesi pretendon

³⁹Diskutimi përfundimtar në lidhje me çështjen penale nr. *** të vitit 2016, në ngarkim të të pandehurve A.GJ, P.GJ, P.GJ, SH.N, D.K, B.K, P.K, G.K, me viktima shtetasit F.Ç, A.Ç, E.R dhe të dëmtuar rëndë shtetasja L.Ç. Akt i qershorit 2016; Vendim mbi moslejimin e hetimeve të kallëzimit penal nr.*** të vitit 2016, akt i datës 21.6.2016, me kallëzues shtetasin F.M; Vendim mbi pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2016 në ngarkim të shtetasit F.A dhe të dëmtuar shtetasen S.P, akt i datës 19.5.2016.

⁴⁰Dokumentin ligjor “Vendim për mosfillimin e procedimit”, akt i datës 15.6.2016, si edhe në fashikullin e materialit kallëzues penal nr. *** të vitit 2016, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Krujë. Akti është i datës 15.6.2016, përpiluar dhe nënshkruar nga Mirela Kapo, me cilësinë e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Me anë të këtij akti prokurorja argumenton se kallëzimi penal duhet të mos fillohet, pasi fakti që ka rezultuar nga verifikimi i materialit kallëzues nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; vendim për pushimin e çështjes penale nr.*** të vitit 2016, akti i datës 17.5.2016, si edhe në dosjen e procedimit penal nr. *** të vitit 2016, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Krujë. Akti është i datës 17.5.2016, përpiluar dhe nënshkruar nga Mirela Kapo me cilësinë e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; vendim për pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2016, akti i datës 15.3.2013, si dhe në dosjen e procedimit penal nr. *** të vitit 2016, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; kërkesë për gjykimin e procedimit penal *** të vitit 2016, akt i datës 27.7.2016, si dhe në dosjen e procedimit penal nr. *** të vitit 2016, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2016, akt i datës 5.5.2016, si dhe në dosjen e procedimit penal nr.*** të vitit 2016, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

⁴¹Denoncimi nr. ***, datë 12.10.2018, i shtetasit P.A; denoncimi nr. ***, datë 9.1.2019, denoncues “Raiffeisen Bank”.

⁴²Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, me shkresën nr. *** prot., datë 13.4.2022, informon se procedimi penal nr. *** i vitit 2018, regjistruar për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal me shortin elektronik, kjo çështje i ka kaluar për ndjekje prokurorit F.B. Prokurorja Mirela Kapo nuk e ka ndjekur asnjëherë këtë procedim. Bashkëlidhet me përgjigjen dhe fletë nga regjistri elektronik i kallëzimeve penale, në të cilin konstatohet se kallëzimi i shtetasit R.M është ndjekur nga prokurori F.B.

se kryeregjistruesi i ZVRPP-së Krujë ka shpërdoruar detyrën për shkak të moszbatimit nga ana e tij të VKM-së Nr. 608, viti 2012. Denoncuesi i bashkëlidh denoncimit kopje të akteve të materialit nr. *** regj., datë 11.2.2015, të regjistruara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

47.1.1 Nga studimi i materialeve penale të bashkëlidhura nga denoncuesi konstatohet vendim mosfillimi i datës 14.4.2016, dhënë nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me kallëzimin penal nr.*** i vitit 2016. Vendimi i mosfillimit të procedimit është marrë pasi, sipas subjektit, nga hetimi ka rezultuar se fakti nuk përbën vepër penale. Për verifikimin e vërtetësisë së fakteve dhe rrethanave sa më sipër Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për aktet penale të vendimit të mosfillimit, datë 14.4.2016, marrë nga subjekti i rivlerësimit⁴³.

47.1.2 Sipas akteve penale rezulton se në datën 11.2.2016 shtetasi P.A ka paraqitur kallëzim penal ndaj shtetasit N.N, me detyrë regjistrues në ZVRPP-në Krujë në lidhje me regjistrimin në mënyrë të kundërligjshme nga ana e këtij të fundit të pronës në favor të shtetasit S.Z, duke përdorur si dokument vendimin nr. ***, akti i datës 3.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, “Për deklaram moskompetencë”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr. ***, datë 10.12.2015, ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore për gjykimin e çështjes civile nr. *** akti, datë regjistrimi 3.12.2015, dhe dërgimin e akteve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Rrethanat e faktit

Mbi bazën e një kërkesë të bërë nga ana e shtetasit S.Z me objekt “kalim në pronësi të pasurisë me nr. *** ZK***, me sipërfaqe ndërtimi 62.25 m², sipërfaqe trualli 200 m², me vendimin nr. ***, datë 20.7.2015”, ka vendosur: “Kalimin në pronësi të pasurisë me sipërfaqe ndërtimi 62.25 m², sipërfaqe trualli 200 m², të subjektit S.Z”. Regjistrimi i kësaj pasurie është bërë në bazë të VKM-së Nr. 608, datë 5.9.2012 “Për përcaktimin e procedurave të kalimit të pronësisë të pasurisë të paluajtshme, të ndërtuar deri në datën 10.8.1991 dhe truallit funksional të tyre kur nuk posedohen akte posedimi pronësie”, duke qenë se bëhet fjalë për pasuri të ndërtuar para vitit 1991.

47.1.3 Në përfundim të hetimit, subjekti i rivlerësimit, me vendimin datë 14.4.2016, ka vendosur të mosfillojë hetimet në lidhje me kallëzimin penal nr. *** të vitit 2016, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

47.1.4 Ndaj vendimit të mosfillimit është ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, e cila, me vendimin nr. *** akti, datë 13.7.2016, ka vendosur mospranimin e ankimit të shtetasit P.A. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 13.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Gjykata e Apelit arrin në konkluzionin se vendimi i gjykatës nuk ka shkaqe ligjore që të bëhet i cenueshëm për sa pretendohet në ankim, pasi nuk konstatohet ndonjë veprim që nuk është kryer nga ana e prokurorit që, nëse do të kryhej, mund të bënte prokurorin ose gjykatën

⁴³Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 13.4.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

të arrinte në një konkluzion të ndryshëm nga ai që ka arritur prokurori. Prokurori ka pasur në dispozicion të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të arritur në këtë konkluzion, se ekziston një nga shkaqet e parashikuara në nenin 290 të Kodit të Procedurës Penale dhe përkatësisht ai i parashikuar në germën “ç”, “Për mosfillimin” e procedimit penal.

47.1.5 Në këtë kuptim, vlerësohet se bazuar në pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektesinë e vendimit dhe themelit të çështjes. Nuk u konstatuan shkelje procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit. Gjykata e Apelit në vendimin e saj nuk ka konstatuar shkelje procedurale dhe hetimi apo drejtimi i hetimeve është kompetencë e prokurorit të çështjes, që ka të bëjë me themelin e çështjes, me vendimmarrjen e subjektit, sikurse u sqarua më lart, gjykimi i së cilës nuk është kompetencë e Komisionit. Verifikimi i ligjshmërisë së veprimeve hetimore të subjektit të rivlerësimit i është nënshtruar kontrollit gjyqësor, ku Gjykata e Apelit e ka çmuar të drejtë vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit për mosfillimin e kallëzimit penal nr. *** të vitit 2016.

Denoncimi nr. * prot., datë 9.1.2019, i “Raiffeisen Bank”**

47.2 “Raiffeisen Bank” ka pretenduar në denoncim se nga ana e subjektit të rivlerësimit janë cenuar rëndë të drejtat ligjore dhe interesat financiarë, të shkaktuara nga një shkelje flagrante që tregon jo vetëm tejkallim të kompetencave nga subjekti i rivlerësimit Mirela Kapo, por edhe qëndrim joprofesional dhe joetik të tyre. Në vijim të hetimit⁴⁴, Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për akte të procedimit penal nr. ***, datë 18.6.2018, bashkëlidhur denoncimit nga “Raiffeisen Bank”⁴⁵.

47.2.1 Sipas akteve penale, rezulton se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë në datën 18.6.2018 është depozituar kallëzim penal nga ana e shtetasës M.RR, e cila ka pretenduar për falsifikim të kryer nga “Raiffeisen Bank”. Shtetasja M.RR pas divorcit ka rënë në dijeni të faktit se disa nga pasuritë e paluajtshme të vëna gjatë regjimit martesor ishin lënë si kolateral nga bashkëshorti i saj dhe kunati (vëllai i bashkëshortit) pa pëlqimin e saj për disa kredi të marra. Shtetasja M.RR ka pretenduar në kallëzimin e saj se aktet e kredisë dhe prokura lënë nga bashkëshorti i saj për vëllain, shtetasin B.RR, janë përpiluar dhe hartuar nga “Raiffeisen Bank” në shqip dhe se ajo nuk e njeh gjuhën shqipe dhe nuk është në dijeni e në njohje të këtyre akteve. Kallëzimi pas regjistrimit i ka kaluar për kryerje dhe ndjekje të veprimeve hetimore subjektit të rivlerësimit.

47.2.2 Pas regjistrimit të procedimit penal nr. *** për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, subjekti ka vendosur kryerjen e një sërë veprimesh hetimore mbështetur në ligjin procedural penal me qëllim identifikimin e veprës penale dhe autorëve të mundshëm.

Subjekti i rivlerësimit ka vendosur sekuestrimin e dosjeve të kontratave bankare pranë “Raiffeisen Bank” dhe tek noterët respektivë pranë të cilëve janë ligjëruar këto kontrata. Në

⁴⁴Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 13.4.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

⁴⁵Bashkëlidhet me dokumentacionin vendim nr. ***, datë 20.11.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me palë paditëse M.RR e paditur “Raiffeisen Bank”, B.RR, M.RR, me të cilin në përfundim të gjykimit gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së paditëses M.RR. Ndaj vendimit është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila ka vendosur ndryshimin e vendimit civil nr. ***, datë 27.4.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, rrëzimin e padisë dhe ka arsyetuar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë është marrë në interpretim të gabuar të ligjit procedural.

aktet e sekuestruara pranë “Raiffeisen Bank”, si dhe pranë noterëve tek të cilët janë ligjruar gjatë hetimit aktet e pretenduara të falsifikuara gjatë hetimit, subjekti i rivlerësimit ka konstatuar se në emër dhe për llogari të shtetas M.RR ka vepruar kunati i saj, shtetasi M.RR. Shtetasja M.RR i ka dhënë prokurën nr. ***, datë 28.10.2011, në gjuhën gjermane të përkthyer në shqip bashkëshortit të saj. Prokura nr. ***, datë 28.10.2011, lëshuar në gjuhën gjermane nga paditësja, është nënshkruar rregullisht nga ana e saj dhe më pas është përkthyer në gjuhën shqipe. Me anë të kësaj prokure shtetasja M.RR i jep tagra ish-kunatit të saj të vendosë barrë mbi pasuritë e paluajtshme dhe nuk ka kufizuar rrethin e personave që mund të rëndohen me barrë hipotekore, duke lidhur këtë kufizim me vendndodhjen e tyre në Republikën e Shqipërisë. Pra, çdo pasuri e saj e ndodhur në Shqipëri mund të rëndohet në emër të saj nga përfaqësuesi me qëllim marrjen e kredisë nga kreditorë. Në këtë prokurë nuk ka një kufizim kohor për kryerjen e veprimeve nga i përfaqësuari. Gjithashtu, prokura nuk ka kufizim në lidhje me shumën e kredive që shoqëria dhe bashkëkredimarrësit mund të kërkonin dhe përfitonin me anë të hipotekimit të pjesës takuese të pronësisë së paditëses. Nuk vihet re gjithashtu që shtetasja M.RR të ketë vënë në dijeni “Raiffeisen Bank” në lidhje me revokimin e kësaj prokure apo mbarimin e saj, kërkesa këto të parashikuara në nenet 74 dhe 76 të Kodit Civil.

Në vijim të veprimeve hetimore të ndjekura nga subjekti i rivlerësimit, noterja M.S bën me dije se prokura e palegalizuar dhe në gjuhën shqipe, e lëshuar nga shtetasja M.RR për bashkëshortin e saj B.RR, nuk është përdorur për nënshkrimin e kontratave, pasi vetë shtetasi B.RR nuk ka qenë prezent në nënshkrimin e tyre dhe ka lëshuar prokurën nr. ***, datë 24.10.2011, për vëllain e tij M.RR, duke e autorizuar atë për firmosjen e kontratës së hipotekës.

47.2.3 Në përfundim të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se nuk është përdorur asnjë dokument i falsifikuar i krijuar i tillë në mënyrë të qëllimshme, që të cenoheshin interesat e kallëzueses apo që të krijonte përfitime të padrejta për personat e tjerë. Rrjedhimisht, për sa kohë mungon një dokument i falsifikuar, nuk rezulton të jetë përdorur një i tillë. Në përfundim të hetimit për shkak se: (a) ka mungesa të elementeve të figurës së krimit të parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal; (b) fakti i ndodhur ka natyrë juridiko-civile e, për shkak të mungesës së elementeve, nuk përbën vepër penale; (c) nuk janë konsumuar elemente të veprave penale të tjera – subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me kërkesë për pushimin e çështjes datë 23.1.2019. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr. ***, datë 21.3.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe pushimin e procedimit penal nr.*** të vitit 2018, për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Ndaj vendimit është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. ***, datë 29.5.2019, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit penal nr. ***, akti i datës 21.3.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë”.

48. Duke analizuar në tërësi veprimet hetimore të kryera për procedimet penale për kallëzimin penal, kallëzimin penal nr. *** i vitit 2016 dhe procedimi penal nr. ***, me objekt “falsifikim i dokumenteve” në ngarkim të “Raiffeisen Bank”, trupi gjykues çmoi se nga tërësia e veprimeve procedurale nuk konstatohen veprime dhe mosveprime individuale të subjektit të rivlerësimit, të cilat kanë çuar në zvarritjen e pajustificuar të veprimeve hetimore,

si dhe moskryerje të veprimeve hetimore lidhur me ngjarjen. Trupi gjykues vlerëson të theksojë se, pavarësisht se në një kallëzim penal tregohet një fakt dhe kryhet një cilësim ligjor penal i faktit të pretenduar, është prokurori ai, i cili pasi kryen një hetim të plotë të ngjarjes, bën cilësimin e saktë ligjor nga pikëpamja e së drejtës penale. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit në kuptim të nenit E, pikat 3 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës, nuk mund të vijë ndesh me dispozitat procedurale, që parashikohen në nenet 24, 327/2 dhe 221 të Kodit të Procedurës Penale. Detyrimi i Komisionit është të verifikojë nëse organi i akuzës ka zhvilluar hetime të plota, të gjithanshme në ushtrim të funksionit të tij kushtetues si prokuror. Nga hetimi i Komisionit nuk rezulton mosmarrje parasysh e kërkesave për kryerje të veprimeve hetimore apo tregohen veprime hetimore, që sipas ligjit duhet të ishin bërë, por nuk ishin kryer, të cilat do të vlerësoheshin si të domosdoshme për arritjen e një konkluzioni të drejtë në kuptim të pikës 3 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës për t'u vlerësuar nga Komisioni si aftësi profesionale. Denoncimet nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit të subjektit.

Në asnjë rast subjekti i rivlerësimit Mirela Kapo nuk është bërë shkak me veprimet apo mosveprimet e saj për tejkalimet e afateve të hetimit. Subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016. Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Për sa më sipër, sipas gremës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, pasi ka çmuar faktet dhe rrethanat që lidhen me aktet e shqyrtuara më herët nga KLP-ja, si dhe me denoncimet nga publiku, nga një vlerësim i përgjithshëm i kriterit profesional, subjekti i rivlerësimit vlerësohet “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të gremës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Mirela Kapo ka plotësuar së bashku kushtet si vijon:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të gremës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të gremës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Mirela Kapo, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, aktualisht me detyrë ndihmës magjistrate në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Vendimi u shpall në Tiranë në datën 22.11.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO

Kryesuese

Alma FASKAJ

Relatore

Xhensila PINE

Anëtare

*Sekretare gjyqësore
Albana Plaka*